



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr.28/2019(JR)
Nr. 28/2 regj.

Tiranë, më 18.09.2020

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën **e enjte**, në datën **15.10.2020**, ora **10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 28/2019, datë 24.05.2019, që i përket, ankimit të subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini kundër vendimit nr. 124, datë 26.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjyqësor
Relatore e Çështjes
Gjyqtar
Gjyqtare
Gjyqtare

Sokol Çomo
Rezarta Schuetz
Ardian Hajdari
Natasha Mulaj
Ina Rama

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës se shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUES I TRUPIT GJYKËS
GJYQTAR

SOKOL ÇOMO

